

E VEÇANTA E BESIMIT TË KRISHTERË

Në botën e sotme, karakterizuar nga pluralizmi fetar, gjenden shumë forma feje në të cilat besimtarët janë të thirrur jo për të luftuar me njëri-tjetrin, por për të dialoguar mes tyre. Por që ky dialog ndërfe-tar të jetë i saktë dhe të mos transformohet në një sinkretizëm fetar, që në ditët e sotme është një rrezik i rëndë, është e domosdoshme që çdo besim të paraqitet në pikëpjekjen e dialogut me identitetin dhe karakteret e tij specifike. Që atëherë domosdoshmëria për të krishterët për t'u thelluar në besimin e vet, për të nxjerrë në pah të veçantën e saj, dua të them karakterin për të cilin ai besim i mbajtur nga ata është i krishterë dhe dallohet rrënjësisht nga të gjitha besimet e tjera. Çfarë e bën atëherë që besimi ynë të jetë i "krishterë"?

Në shumë fjalorë besimi përcaktohet "një akt i intelektit që vendos për të pranuar mësimet të përcaktuara ose koncepte ose thënie, lajme etj (*objekti lëndor i besimit*), jo për qartësinë e tyre të brendëshme ose për njohjen e drejtëpërdrejtë, por për arsye se bazohen në autoritetin e një dëshmitari (*objekti formal i besimit*), që meriton të jetë besuar nësa parimisht mbahet se nuk do të gënjëhemi as nuk ka qëllim për të gënjyer". Prandaj në kuptimin e saj të përgjithshëm kulturor feja tregon pranimin e mendjes nësa pohon një dëshmitar në të cilin kemi besim: prandaj një pranim i bazuar në ndonjë gjë të cilën ne nuk e shohim të qartë, por ne shohim se në vetvete është e mundur ose të paktën nuk shohim se është e pamundur. Prandaj në pranimin e fesë (besimit) ndërhyjnë vullneti që i urdhëron inteligjencën për të pranuar atë gjë megjithëse nuk e sheh të qartë ose nuk ka prova për këtë. Prandaj besimi është një akt i inteligjencës dhe një akt i vullnetit që na bën të besojmë realisht atë çka është vetëm "e mundur" për inteligjencën. Kështu që të kesh besim, të besosh, të kesh shpresë janë fjalë që kanë të njëjtën vlerë, që kanë të përbashkët pranimin e ndonjë gjëje në bazë të një dëshmieje, por dallohen sepse "besimi" i referohet një personi. Ndërsa "feja" i referohet më tepër një pohimi ose një fakti; "besimi" paraqitet më tepër si një akt vullneti, ndërsa feja paraqitet në një pamje

më tepër mendore.

Feja - shpresa - besimi është një eksperiencë universale që qëndron në thellësi të jetës individuale dhe shoqërore, sepse duke qenë e pamundur për të verifikuar çdo gjë nga ne vetë, është e domosdoshme të mbështetemi tek të tjerët, t'u besojmë të tjerëve. Megjithatë feja ka vendin e vet specifik në lëmin fetar, nësa ajo është elementi kryesor i jetës fetare. Por jo në të gjithë besimet feja ka të njëjtën rëndësi. Kështu duke lënë në një anë hë për hë hebraizmin dhe kristianizmin, feja ka një vend themelor në islam: këtu feja (*imam*) është i pari ndër pesë shtyllat (*arkan*) mbi të cilën ai mbështetet, aq sa për t'u bërë mysliman mjafton të shprehësh besimin në fenë myslimane përpara tre dëshmitarëve të kualifikuar se don të jesh mysliman (*shadahab*): “Nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe Muhameti është i dërguari (*rasul*) i tij”. Ai jo vetëm që na sjell një besim në shtatë pika, por përfshin brenda edhe shpresën “në Allahun”: “Thuaj: Ai është i mëshirshmi. Në të besojmë, në të shpresojmë” (*Kur'ani*, s.67, 29). Edhe në parsizëm që i referohet Zoroastrit, besimi (*Zrazdati*) është një koncept qëndror. Në induizëm janë tri “rrugë shpëtimi”: Në “rrugën e veprave” (*karma-marga*) dhe në “rrugën e njohjes” (*jnana-marga*) feja nuk ka asnjë vend; ka përkundrazi një vend shumë të madh në “rrugën e devotshmërisë” (*bhakti-marga*), në të cilën “i devotshmi” (*bhakta*) mbështetet tërësisht në duart e “Zotit” (*jshvara*), që në *Bhakarad* - *Gita* është Krishna. Përkundrazi, në budizëm që mendon se është vetëm e vetëm racional, nuk mund të flasim për besim, edhe në qoftë se në budizëm *Mahayana* “librimi” arrihet jo me ashe, por me shpresë në “Budën” dhe në *bodhisattva*; dhe në budizmin japonez vetëm feja në hirin e Armidës u prin njerëzve në parajsën e “tokës së pastër”.

*

Në qoftë se në shumicën e besimeve feja zë një vend pak o shumë të madh, në hebraizëm dhe në kristianizëm zë një vend qëndror që në kristianizëm vetëm dashuria e kalon atë: “Këto janë tre gjërat - thotë shën Pali - që mbeten: feja, shpresa e dashuria: por mbi të gjitha më e madhja është dashuria (1 Kor. 13,13).

Në Besëlidhjen e Vjetër feja emërtohet me dy emra që rrjedhin nga rrënjët foljore *aman* e *batah*: *aman* (nga vjen *amen*: mbiemër që do të thotë “i sigurtë, besnik”) që mandej merret në kuptimin ndajfoljor, “sigurisht”, “është kështu”, “po”, “ashtu qoftë”) ka dy domethënie: a. “të jesh i përmbajtur pra të jesh i qëndrueshëm” dhe, në fund “të jesh i sigurtë”, “të jesh besnik”: prandaj me këtë fjalë shprehet “qëndrue-

shmëria” që besimtari ndjen fenë për vetë faktin që i mbështetet Zotit, dhe, njëheri, “sigurinë dhe bindjen”, të lidhura me fjalën JHWH, që është “besnik” (*aman*) (Is. 49, 7): b) me pasë shpresë që Zoti do të realizojë atë që ka premtuar: prandaj “me besu” do të thotë me iu mbështetë premtimit të Zotit duke qenë i sigurtë se do të plotësohet çfarë ai ka premtuar. Nga ana tjetër *batah* shpreh “sigurinë” dhe “shpresën”: prandaj “me besu në JHWH” do të thotë “me kenë i sigurtë për JHWH”, “me pasë besim në të”, “me pushu mbi të” dhe prandaj me qenë i qetë përsa i përket së ardhmes, që është në duart e Atij të cilit ne mund t’i besojmë.

Nga rrënja foljore *aman* rrjedhin emra *emunab* dhe *emeth*. I pari tregon fenë e përbërë me besnikëri, së cilës i përgjigjen besimi dhe shpresa: kjo cilësi i përshtatet njerëzve (“i drejti do të jetojë për arsye të fesë-besnikërisë së tij”) (Ab 2,4) ose Zotit (“Zotëri, hiri yt është në qiell, besnikëria jote deri në re” (Ps 35,36,6): I dyti shënon qëndrueshmërinë, sigurinë, besnikërinë, fe dhe të vërtetë (Dua të them gjë të denjë për t’u besuar, që meriton pranimin njerëzor) dhe shpesh është i bashkuar me *besed* (mëshirë, hir) “Zoti të dërgoi besnikërinë e tij dhe hirin e tij” (Ps 56, nr.17, 4): “Të gjitha shtigjet e Zotit janë të vërteta dhe hir për atë që zbaton Besëlidhjen e tij dhe urdhënimet e tija” (Ps 24/25 10). Këtu fjala e vërteta nuk ka kuptimin intelektualist grek do të thotë “bashkëzanim në realen”, por kuptimin hebraik “me qenë i sigurtë”, me qenë një realitet në të cilin ne mund të mbështetemi: Zoti është “i vërtetë” sepse është “besnik”, sepse ne mund të kemi besim tek ai nëse ai është i palëvizshëm dhe i qëndrueshëm. Fjalët e tija janë e vërteta (2 Sam 7, 28): dhe në të vërtetë premtimet hyjnore sigurojnë pavdekshmërinë e shtëpisë së Davidit.

Çfarë është, pra, feja për Besëlidhjen e Vjetër? Njeriu i Besëlidhjes së Vjetër ka, dhe të thellë ndjenjën e ligësisë dhe të pasigurisë së jetës njerëzore, e cila është e nënshtruar vuajtjeve dhe vdekjes dhe se, prandaj, ndien nevojën e madhe me pasë një mbështetje të fuqishme që të mund t’i japi qëndrueshmëri dhe siguri. E vetmja mbështetje e fuqishme është JHWH sepse ai është “një shkëmb” dhe një “mburojë”: “Të dua, o Zot fuqia ime; o Zot shkëmbi im, kështjella ime, Shpëtimtari im; Zoti im, shkëmbi im në të cilin unë gjej strehim; mburoja dhe shpëtimi im i fuqishëm” (Ps 17, 18 2-3). Prandaj, për njeriun e Besëlidhjes së Vjetër feja ka brenda vetes para së gjithash ndjenjën e ligësisë së vet që e shtyn me iu sjellë JHWH për të gjetë në te qëndrueshmëri dhe siguri për të cilën ka nevojë; ka brenda vetes pastaj një

ndjenjë shprese, sepse JHWH është “besnik” dhe “i vërtetë” dhe se pra, mund të kemi besim tek Ai dhe tek fjala e tij. Prandaj për njeriun e Besëlidhjes së Vjetër besimi është më u mbështetë plot shpresë tek Zoti “besnik” dhe tek Fjala e Tij e së “vërtetës”. Por fjala së cilës besimtari i mbështetet është para së gjithash zbulimi i Zotit: atëherë feja është mbështetje e mendjes dhe e zemres gjërave që Zoti ka zbuluar. Fjala e Zotit është edhe premtim për një të ardhme shpëtimit: atëherë feja është një siguri plot shpresë se Zoti do të kryejë çka ka premtuar. Më së fundi Fjala e Zotit është urdhërim dhe ligj: atëherë feja është dëgjuesë dhe besnikëri ndaj gjërave që Ai na urdhëron.

*

Në Besëlidhjen e Vjetër flitet për fe për të parën herë në ngjarjen e Abrahamit. Atij që i ankohet Zotit se nuk i ka dhënë një trashëgimi Zoti i premtim se do t’i japë një fis të madh sa yjet e qiellit: “Ai i besoi Zotit, që ia dha këtë premtim si një e drejtë e tija” (Zan 15, 6). Në çfarë konsiston atëherë feja e Abrahamit, për të cilën ai u bë prototipi i besimtarit, “ati” i gjithë besimtarëve (Rom 4, 12, 16)? Konsiston në faktin që Abrahami, kundër çdo pritjeje, sepse ai dhe Sarah, gruaja e tij, janë të shtyer në mot, i beson premtimit të Zotit dhe mbi këtë premtim ai bazon gjithë qenien e tij, në sigurinë se Zoti do ta mbajë fjalën e tij, megjithëse më vonë do t’i kërkojë t’i flijojë vetë birin e tij të premtimit, Isakun.

Si Abrahami, edhe Moisiu i beson JHWH që i është zbuluar atij për ta dërguar tek Faraoni, duke i premtuar se “do të jetë me të” për t’i prirë popullit të Izraelit në tokën e premtuar. Dorëzanë mes JHWH dhe popullit të tij, Moisiu i zbulon popullit planet e Zotit dhe me çudirat që ai kryen provon burimin hyjnor të misionit të tij. Kështu populli, mbas kalimit të Detit të Kuq, “pati frikë Zotin dhe besoi në Të, dhe në shërbëtorin e tij Moisiun” (Es 14, 31).

Dy janë mbështetjet e fesë te populli i Izraelit. Para së gjithash ai beson se JHWH është Zoti i vetëm dhe që jashtë tij “nuk ka një tjetër” (Dt 4,39); beson mandej që JHWH nëpërmjet Moisiut ka çliruar Izraelin nga skllavëria egiptiane dhe mbi malin Sinei, ka lidhur me të një Besëlidhje në fuqi të së cilës Izraeli është bërë populli i “tij”. Besëlidhja sjell nga ana e Zotit zotimin me ndihmë dhe me shpëtue Izraelin dhe me i dhanë tokën e premtuar Abrahamit; nga ana e Izraelit sjell “fenë”, dua të them para së gjithash besnikërinë për të dëgjuar fjalën e JHWH dhe për të mos u çuar kundër tij (Dt 9,23-34): sepse me ndigjue zërin e JHWH do të thotë me besue ne Të; mandej besimi që

JHWH do të jetë besnik në premtimet e tij, sepse Ai është “Zoti besnik, që e ruan besëlidhjen e vet dhe mirësinë e tij në mijëra gjenerata me ata që e duan dhe që mbajnë urdhërimet e tija (Dt 7,9). Kështu fati i Izraelit është i lidhur me fenë e tij, dua të them me besnikërinë e tij për të dëgjuar JHWH, duke mbajtur ligjin e tij dhe duke shpresuar në mbrojtjen e Zotit “të vet”. Prandaj, mungesa e besimit do të jetë për Izraelin, rrënimi i tij. Për këtë arsye profetët padisin mungesën e besimit në Izrael: mungesë që shprehet para së gjithash, në idhujtari, që është mohimi i JHWH si Zot i vetëm, dhe mandej në kërkimin me besëlidhjet e huaja, që është mohimi i shpresës që Izraeli duhet të ushqejë në JHWH, i vetmi që mund ta shpëtojë nga armiqët e tij.

Porfet i kësaj feje është kryesisht Isaia. Ai i lajmëron mbretit Akaz: “Në qoftë se nuk do të besoni, nuk do të keni qëndrueshmëri (Iz 7,9b), dhe padit dërgimin e ambasadorëve në Egjipt për t’i kërkuar ndihmë faraonit kundër asirve që kërcënojnë Jeruzalemin: “Vaj për ata që shkojnë në Egjipt për të kërkuar ndihmë, dhe vënë shpresën e tyre në kuajt, duke shpresuar në qerret sepse janë të shumta dhe në kavalerinë sepse është shumë e fuqishme, pa shikuar kah shejti i Izraelit dhe pa kërkuar Zotin (Is 31,1). Për Izraelin është mëkat më vendosë shpresën në një fuqi njerëzore - “Egjiptiani është një njeri dhe jo një Zot” (Iz 31, 3) - dhe jo në JHWH që vetëm ai mund ta shpëtojë nga fuqia asiriane; është një mungesë feje në shenjtin e Izraelit që kështu e qorton popullin e vet: “Në kthim dhe në qetësi qëndron shpëtimi juaj, braktisjen plot shpresë (= në fe) qëndron forca juaj” (Iz 30, 15). Për të njëjtin mëkat të mungesës së fesë paditë edhe Jeremia: “I mallkuar njeriu që shpreson në njeriun, vendos në mish (domethënë në *njeriun, nësa ai është një qenie e ligësht dhe e thyeshme*) mbështetjen e vet ... Bekuar njeriu që shpreson në Zotin dhe Zoti është shpresa e tij” (Jer 17, 37).

Në të vërtetë thirrjet për të pasë fe që lëshojnë profetët nuk janë të dëgjuara nga populli i Izraelit në tërësi (Jer 29, 19). Vetëm një grup i vogël “të varfërish” do të jetë në historinë e Izraelit mbas mërgimit “populli i besimit”: “Do të bëj të qëndrojnë mes teje një popull të përlulur dhe të varfër: do të besojë në emrin e Zotit pjesa tjetër e Izraelit (Sof.3, 12-13). Figura shëmbullore e këtij populli do të jetë Shërbëtori i JHWH që i vendosur përpara një prove të tmerrshme qëndron me një “fytirë të ashpër si një gur, duke ditur se nuk do të mbetet i gënjer”, sepse ka absolute që Zoti “i ndihmon” (Iz.50,7). Prandaj fton të gjithë ata që janë në terr për të shpresuar në JHWH: “Ai që ec në terr, pa pasë dritë, të shpresojë në emrin e Zotit, t’i mbështetet Zotit të tij” (Iz.50, 10).

Popullit të fesë i përkasin psalmistët, që e shprehin mjaft shpesh shpresën absolute që ata kanë në Zotin, Shkëmb: “Në ty o Zot, kam gjetë strehim, nuk do të mbetem i zhgënjyer. (...) Ti je shkëmbi im dhe mburoja ime. Mbështetem në duart e tua; ti më shpëton o Zot, Hyu im besnik” (Ps 30/31, 2-6). Në të vërtetë i gjithë Psalteri shpreh besimin e Izraelit në JHWH Hy i vetëm, krijues i gjithpushtetshëm, Zot besnik dhe i mëshirshëm për popullin e tij, mbret i përgjithshëm i së ardhmes. Por mbi të gjitha në përshpirtësinë individuale feja bëhet shpresë absolute edhe ndër provat më të forta: një shpresë që qetëson psalmistin (Ps 4, 8-9) dhe i bën të shohë jetën e amshuar me Zotin: “për këtë gëzon zemra ime, gëzon shpirti im; dhe trupi im pushon në siguri. Sepse ti nuk do të braktisësh jetën time në varr, as nuk do të lësh që shenjtë yt të shohë prishjen. Do të më tregosh shtegun e jetës, gëzim i plotë në pratinë tënde, ëmbëlsi pa fund në të djathtën tënde (Ps 15/16, 9-11). Me “të varfërit” shprehin fenë e tyre dhe të diturit e Izraelit: “Mos thuaj: “Dua të hakmerrem për të keqen”; shpresë në Zotin dhe ai do të lirojë” (Prv 20, 22); janë kryesisht martirët që preferojnë të vdesin përpara se të cënojnë ligjin e Zotit dhe kështu “Të shnderojnë besëlidhjen e shenjtë” (1 Mat 1, 63). Ata besojnë që Zoti “do të ngjallë në një jetë të re dhe të amshuar” (2 Mak 7, 9). Duke përfunduar feja në Besëlidhjen e Vjetër shpreh qëndrimin bazë të një izraeliti përballë JHWH, Zot i besëlidhjes dhe shpëtimtar i popullit të tij. Ajo ka si përfundim njohjen e JHWH dhe të fuqisë së tij shpëtimtare që tregohet hapur në të gjithë historinë e Izraelit, në veçanti në çlirimin nga Egjipti dhe në hyrjen në tokën e premtuar; në shpresën që JHWH, i mëshirshëm dhe besnik, do të mbajë premtimet e tija, pavarësisht nga pabesia e popullit të tij; në dëgjimin e Zotit dhe në dëgjuesën e urdhërave të tij, Arsye kjo për të cilën në besëlidhjen e vjetër të besosh është të shpresosh në JHWH të mbështetesh në te dhe të thuash *Amen* (domethënë po) fjalëve të tij, premtimeve të tij, ligjeve të tij.

Po që se tani nga BV (Besëlidhja e Vjetër) kalojmë në BR (Besëlidhja e Re) vërejmë që besimi ka një vend shumë më të rëndësishëm dhe të përcaktuar se në BV. Është tregues fakti që ndërsa në BV folja *aman* (me besue) gjendet 51 herë dhe emri *'emunah* (besim) 49 herë, në BR folja *pisteuein* (me besue) dhe emri *pistis* (besim) gjendet 243 herë. Por rëndësia vendimtare që BR i jep fesë shkon përtej faktit të thjeshtë se aty flitet me një numër kaq të madh herësh.

Le të shikojmë para së gjithash domethënien e fjalëve me të cilën në BR shënohet feja. *Pisteuei* ka tre domethënie: a) domethënë me besue

atë çka thotë një person: “Ti nuk i ke besue (*ouk episteusas*) fjalëve të mia (Lk 1,20); b) tregon *me besue (eis) dikujt*, domethënë me mbajt të vërtetë atë çka një person thotë për veten e tij “Kështu me besue në Krishtin” (Gj 3,8; Gal2,16) shënon se Jezusi është biri i Zotit; ose *me besue që (Zoti) Jezusi është Krishti* (Gjn 20,31); c9 shënon *me pasë besim* të plotë që ajo gjë që ne i kërkojmë do të nxirret nga Zoti ose nga krishti me siguri: “Çdo gjë që do të lypni me besim (pisteuontes) në lutje, do ta nxirni” (Mt 21,22)

Emri *pistis* shënon: a) besim, shpres në Zotin; besim shpresë në Jezusin dhe *në ndihmën e tij* në rast sëmundjeje ose nevoje; b) besimin e vërtetë, autentik: ky duket se është kuptimi i rreshtit të famshëm: “Biri i njeriut, kur do të vijë, do të gjejë fenë (*pistin*) përmbi tokë?” (Lk 18,8); c) objektin dhe përmbajtjen e fesë: kështu letra e (Fesinjve 4,5) duke folur për “një fe të vetme” (*mia pistis*) ka për qëllim të thotë se të gjithë besojnë të njëjtat gjëra.

Por cili është karakteri specifik i besimit në BV ndaj atij të Br? Pa dyshim besimi i BR vazhdon besimin e BV dhe ka ne të shumë pika të përbashkëta aq sa ndonjë ka thënë se besimi BR është një “trashëgimi judaike”. (Hwvindisch). Megjithatë ajo që e dallon besimin e BR nga si i BR është persona e Krishtit: të besosh në JHWH të izraelitit është të besosh në Jezu Krishtin e të krishterit. Ndërsa BV e vinte njeriun përballë JHWH BV e vë përballë Krishtit. Sigurisht edhe i krishteri beson në Krishtin e Bv por e shikon si Atin e “Zotërisë tonë Jezu Krishtin” si atë që ka dërguar në botë birin e tij Jezu Krishtin, e ka ngjallur nga të vdekurit dhe e ka bërë të qëndrojë në të djathtën e tij.

Çfarë është atëherë, besimi në BR? Është para së gjithash njohim se Jezusi i Nazaretit është Mesia i premtuar dhe biri i Zotit i bërë njeri. Në Ungjill gjenden dy pyetje që bën Jezusi. I pyet nxënësit e tij: “Ju kush thoni se jam unë?” Simoni në emër të shokëve të tij, përgjigjet: “Ti je Krishti (=Mesia), biri i Hyjit të gjallë” (Mt 16, 15-16). E pyet pastaj të verbërin e lindur që ai ka shëruar: “A beson ti në birin e njeriut?” I verbëri përgjigjet: “Unë besoj zotëri”. (Gjn 9,35-38). Në këto dy përgjigje është përfshirë besimi sipas BR. Pastaj është shprehur në trajtën e saj më të plotë në fjalët që thotë nxënësi Toma, mbasi që Jezusi i ngjallur e ka ftuar të shtij gishtin etij në birën e gozhdëve dhe dorën e tij në plagën e krahavorit: “Zoti im e Hyji im” (Gjn 20,28). Kështu që besimi i “krishterë” konsiston pikërisht në besimin e brendshëm dhe në deklarin e jashtëm që Jezusi i Nazaretit - një personazh historik, lindur në Betlehem në kohën e perandorit August, kryqëzuar

dhe vdekur në Jeruzalem në kohën e perandorit Tiber - është Zot. Hyjnia e Jezusit të Nazaretit prandaj është shenja dalluese e besimit kristian: kush nuk beson se Jezusi është Zot, sa do ta admirojë duke e mbajtur për një xheni fetare, një mësues i pa kalueshëm morali ose edhe njeriu në të cilin Hyji është treguar në një mënyrë unike nuk e ka besimin e krishterë. Në të vërtetë, s'ka njeri që, duke njohur edhe në një mënyrë sipërfaqësore Jezusin e Nazaretit, çfarë ai ka thënë dhe çfarë ai ka bërë, nuk provon për të në nderim dhe çudi dhe nuke mban për një njeri të jstëzakonshëm ndoshta edhe njeriu më i jashtëzakonshëm që ka parë historia; dhe megjithatë gjithë ato gjëra nuk janë të mjaftueshme që një person të quhet "i krishterë" sepse i "krishterë" është vetëm ai që beson se Jezusi është Zot. Është i njohur vendi krejtësisht i veçantë që Jezusi zë në Kur'an. *Me të vërtetë Isa ibn Maryam* (Jezusi biri i Marisë) është lajmëtari i Hyjit, fjala e tij që Ai e vuri në Marinë" (S.171). Për të thuhet se pati një ngjizje virgjërore dhe thuhet që është një profet që Hyji e ka bërë "përmbi" të gjithë të tjerët dhe të përforcuar "me shpirtin e shenjtërisë" (S 253), vetëm Muhameti është më i madh se ai sepse ky është "vula e profetëve"; thuhet edhe me fuqi që ai nuk është Biri i Hyjit por një shërbëtor i thjeshtë i Hyjit (S. 4,171-172; S.9 30-32). Me pohu se Jezusi është biri i Hyjit mishëruar dhe vdekur mbi kryq për shpërblimin e njerëzve është për kuranin (S. 3,72) një "kob". Jezusi ka qënë vetëm një musliman i "pershpirtshë, i devotshëm ndaj Allahut". Kështu besimi në Hyjninë e Jezusit e ndan rrënjësisht besimin kristian nga ai islamik.

E njëjta gjë duhet thënë edhe për besimin ebraik: në krahasim me ebrenjtë e kohës së vjetër që, si duket edhe në *Talmud* ishin një shumicë e madhe që ushqenin për Jezusin urrejtje dhe përbuzje, hebrenjtë e sotëm në përgjithësi thonë se Jezusi ka qënë një hebre i vërtetë, një hebre i përsipirtshëm, një *hasid* besnik dhe që respektonte *Torahun*; por sikurse edhe ebrenjtë e së kaluarës nuk e pranojnë hyjninë e Jezusit duke pohuar që hyjnzimi i tij ka qënë e Palit dhe të bashkësive të para kristiane me kulturë greke, që e kanë bërë atë një rabbi, armik të popullit të tij dhe të prishje së Torahut. Si përfundim besimi kristian është kryesisht kristocentrik, në kuptimin që persona e Jezusit, bir i njeriu të mishnuar, të kryqëzuar e të ringjallur është qendra dhe zemra e besimit të krishterë.



Por çfarë sjell me vete "besimi në Krishtin"? Para së gjithash vetëdijen e thellë që njeriu është mëkatar larg nga Hyji dhe skllav i mëkatit

Teologji

dhe i fuqive të së keqes dhe që pa Krishtin ai nuk mund të çlirohet nga mëkati dhe të shkojë tek Hyji; sjell me vete së dyti dëshirën, vendimin personal me u lidh me Krishtin, Biri i Zotit dhe shpëtimtari i vetëm i njerëzve, duke shpresuar me shpresë të madhe në personin e Krishtit për të qënë shpëtuar dhe sjellur tek Zoti. Prandaj fakti i fesë së Krishterë i përket kryesisht personës së Krishtit që nga ai që e kryen është besuar Biri i Zotit dhe shpëtimtar i njerëzve. Padyshim të besosh në Krishtin sjell me vete edhe pranimin e atyre gjërave që thotë i si fjalë e Zotit, dhe të atyre gjërave që ai kryen si vepër shpëtimtare e Hyjit. Por ajo gjë që e karakterizon besimin e krishterë është që i besohet fjalës dhe veprës së Jezusit sepse i besohet personit të tij: sepse ai është personi që i jep vlerë hyjonre fjalëve dhe veprave të tij. Kjo shenjë dalluese dallon Jezusin nga themeluesit e besimeve të tjera.

Kështu për Budizmin nuk është personi i Buddhës që ka rëndësi (personi që është shpërbërë në elementet e tij duke hyrë në *Nibana* prandaj nuk ekziston me kuptimin që ne, perëndimorët i japim kësaj fjale por është Ligji, *Dhamma*, i përmbajtur në katër të vërtetat e shkëlqyera që ai ka zbuluar dhe predikuar si “rrugë të shpëtimit”; pas vdekjes së Buddhës “Mësuesi” për nxënësit e tij do të jetë *Dhamma*: “Doktrina e Dhamma (nxënës i Buddhës, i privileguari i tij), rregulla (Dhamma) dhe përsa ju përket juve ka paraqitur dhe mësuar ashtu sikurse juve, pas meje, Mësuesi”. (ligji Budist, *Digha Nikaaya*, E. Frola, Bari la terza, 1960,302). Jezusi përkundrazi është - dhe mbetet përgjithnjë - Mësuesi i nxënësve të tij, të cilët kur lexojnë Ungjillin dëgjojnë fjalën e tij e pranojnë sepse është ai që e thotë, duke e bërë të jehojë në shekuj: “Në liturgji - pohon Konçili Vatikan 2 - Krishti lajmëron përsëri Ungjillin e tij” (*Sacrosantum concilium*) dhe shton: “(Jezusi) është i pranishëm në fjalët e tij, sepse është ai kur në kishë lexohet Shkrimi i Shenjtë”.

*

Dy autorë të BR më shumë se të tjerët janë thelluar në misterin e Jezusit dhe domethënien e besimit në personin e tij: janë Pali dhe Gjoni sigurisht, gjithë pikat e BR e vënë besimin në plan të parë. Kështu letra drejtuar Hebrenjve jo vetëm pohon që “pa besim është e pamundur t’i pëlqejmë Zoti” (Eb 11,6) dhe tregon në Jezusin “autorin përkryesin e besimit” (Eb 12,2) por e lexon gjithë historinë e BR si një “histori besimi” (Eb 11,2-38). Letra e parë Pjetrit pohon se të krishterët janë “ruajtësit e fuqisë së Zotit përmes besimit” (1 Pt 1,5) dhe e qorton t’i qëndrojnë “djallit të qëndrueshëm në besim” (1 Pt 5,9). Letra e Judës

shpërthen me një fuqi të pazakontë kundër prishësve të fesë dhe i luftojnë përbesimin që u qe transemutar besimtarëve njëherë e përgjithmonë (Gd 1,3) dhe të ndërtojmë godinën e tyre shpirtërore “mbi besimin e shenjtërueshëm” (Gd 1,20). Megjithatë janë Pali e Gjoni që më gjerësisht dhe më thellësisht kanë folur mbi problemin e besimit.

Për Shën Palin të besosh është të pranosh fjalën e apostujve, dëshmitarë të Jezusit dhe të dëshmosh që ai, Jezusi, është “Zotëria” (1 kor 12,3). Besimi në të vërtetë lind nga dëgjimi i predikimit: “Besimi varet nga predikimi dhe predikimi nga ana e tij vërtetohet nga fjala e Krishtit” (Rom 10,17). Megjithatë jo të gjithë dëgjojnë lajmin e Ungjillit. Prandaj në qoftë se feja qëndron në dëgjimin e predikimit të Ungjillit në “ndigjesën e Krishtit” (2 Kor 10,5) mosbesimi qëndron në mosdashjen e dëgjimit të predikimit Ungjillor dhe në mosbesimin që Jezusi është Zotëria. Por ajo që është karakteristike, sipas, Shën Palit, është që “njeriu është i drejtuar nga besimi, pavarësisht nga veprat e ligjit” (Rom 3,28), sepse “I drejti do të jetojë nëpërmjet besimit” (Rom 1,17). Nuk është pra mbajtja e *Torahut* të shkruar ose gojore ajo që mund ta shpëtojë njeriun dhe që e bën të drejtë përpara Zotit, por vetëm feja, dua të them pranimi i përvujtë i hirit të Zotit, që drejtëson njeriun me anën e vdekjes dhe të ngjalljes së Jezusit. Prandaj besimi qëndron në mbështetje të Krishit të kryqëzuar dhe të ngjallur me mendje dhe zemër dhe duke pritur nga ai shpëtimin: “Në qoftë se ti do të pohosh me gojën tënde që Jezusi është Zotëria, dhe do të besosh me zemrën tënde që Hyji e ka ngjallur nga të vdekurit do të jesh i shpëtuar” (Rom 10,9). Por në qoftë se besimi është “ndigjimi” i Ungjilli të shpëtimit në Krishtin e vdekur e të ngjallur dhe është “një gjest dhe pranim i Ungjillit të Krishtit” (2 Kor 1,19) ai sjell me vete një vendim dhe një ndryshim rrugë: bëhet fjalë të “kthehemi te zotëria” (*epistrepheim pros ton kyriom*) (2 Kor 3,16). Këtë gjë e ka bërë Shën Pali që tanimë jeton në besimin në Krishtin: “Në të vërtetë përmes Ligjit unë jam i vdeku për Ligjin, për të jetuar për Hyjin. Kam qënë kryqëzuar me Krishtin dhe nuk jam më unë që jetoj por Krishti jeton në mua. Kjo jetë që jetoj në mishin tim unë e jetoj në besimin e Birit të Hyjit, që më ka dashur dhe ka dhënë veten e tij për mua” (Gal 2;19-20).

Në përfundim për Shën Palin besimi është gjithmonë një raport personal me Jezu Krishti dhe një pranim i ngjarjeve të tij historike: Krishti sipas Shën Palit është Jezusi, Biri i lindur nga një grua, i kryqëzuar dhe i ngjallur. Nga ana tjetër ngjarjet historike të Jezusit janë të shprehura me fjalë krejt preçize dhe konkrete në “lajmërimin” (*kerygma*) aposto-

Teologji

lik, të cilit i detyrohemi “ndigjim” dhe “ndigjesë” dhe jo në përralla dhe trillime. Ngjarja historike e Jezusit e shprehur në *kerygma* është baza e besimit kristian, të cilin të gjithë duhet ta pranojmë për të formuar “një besim të vetëm” (Ef 4,5) dhe prandaj një Trup i vetëm, dhe një Kishë e vetme. Dhe së fundi besimi do të jetë aq autentik sa i bazuar në dashuri. Sepse besimi i vërtetë është ai “që vepron përmes dashurisë” (Gal 5,6).



Dhe më shumë se Ungjijtë Sinoptikë ai i Gjonit është Ungjilli i besimit. Ai nisët nga koncepti “i dëshmisë” (fjalët *martyrein* = dëshmue dhe *martyria* = dëshmi janë shumë të shpeshta) në fillim të Ungjillit Gjon Pagëzuesi “dëshmon” në favor të Jezusit doke pohuar se ai është “Biri i Hyut” është “qengji i Hyjit që heq mëkatën e botës” (Gjn 1,34-39). Jezusi dëshmon në favor të tij duke deklaruar se ai është “Biri i njeriut zbritur nga qielli” (Gjn 3,18), para së gjithash me fjalën e tij, sepse ai dëshmon atë që ka parë (Gjn 3,11), por edhe me “shenja”, çudira që ai kryen. Mbi të gjitha, në favor të Jezusit dëshmon, vetë Hyji, Ati: atyre që akuzojnë se dëshmia e tij për veten e tij nuk është e pranueshme Jezusi përgjigjet që nuk është vetëm ai që dëshmon në favor të vet: “edhe Ati që më ka dërguar, jep dëshmi për mua (Gjn 8,18). Dhe në të vërtetë mrekullitë që ai kryen janë “vepër e Atit” (Gjn 10,37), që “Ati i ka vënë për detyrë të kryejë”: “ato dëshmojnë për mua që Ati më ka dërguar” (Gjn 5,36).

E atëherë çfarë është besimi? Është një mbledhje e dëshmimeve të Atit i cili duke i dhënë pushtetin Jezusit të kryejë mrekulli, autentifikon misionin e tij si i dërguar i Hyjit në botë. Prandaj kush beson në Jezusin, duke pranuar dëshminë e Atit në favor të tij, “vërteton se Hyji është i vërtetë” (Gjn 3,33). Ndërsa ai që nuk e pranon e bën Zotin një rrencak, sepse nuk beson në dëshminë që Hyji ka dhënë për Birin e tij” (1 Gjn 5,10).

Por çfarë dëshmon Jezusi për veten e tij? Para së gjithash ai dëshmon se është Hyj, duke i vënë vetes pikërisht emrin e Hyjit në BV: “Unë jam” i thotë pra kundërshtarëve të tij “judenj”: në qoftë se ju nuk besoni “Unë Jam” ju do të vdisni në mëkatet tuaja (Gjn 8,24): dëshmon pastaj se është Biri i Hyjit dhe se është një gjë e vetme me Ati: “Unë dhe Ati jemi një gjë e vetme” (Ben esmen) (Gjn 10,30); dëshmon se ka qënë dërguar nga Ati i cili ka vënë gjithçka në duart e tij, edhe gjykimin e njerëzve dhe fatin e tyre të amshuar (Gjn 5,22); dhe së fundi dëshmon se ai është “drita e botës” (Gjn 9,25), “buka e jetës” (Gjn

6,33), i vetëm ndëmjetës i zbulesës dhe i shpëtimit, e vetmja rrugë që të çon tek Ati, “Askush nuk vjen te Ati veçse nëpër mua”, “ngjallja dhe jeta”, kështu që ai që beson në të ka kaluar nga vdekja në jetë (Gjn 5,24) dhe “ka - që tani - jetën e pasosur” (Gjn 3,36). Të besosh në Krishtin do të thotë të pranosh për të vërteta këto veçori të Krishtit. Feja prandaj sjell një përmbajtje doktrinale që kuptimi njerëzor duhet të pranojë me përvujtëri dhe ëmbëlsi ndaj atij që është vetë e vërteta, Jezu Krishti.

Por cili është fati i atij që nuk pranon të besojë? Ai “është i dënuar, sepse nuk ka besuar në emrin e Birit të vetëm të Hyt” (Gjn 3,18). Ai gjendet në mëkat dhe në vdekje: “Kush beson në Birin ka jetën e pasosur por kush nuk dëgjon (= nuk beson) Birin nuk do të shohë jetën por mëria e Hyjit do të bjerë përmbi të” (Gjn 3,36). Kështu që besimi ka një madhëri të vetën tragjike, sepse vë si kusht përcaktimin e pasosur të njeriut: me kërkue të besosh është me kërkue të jetosh, të qëndrosh në pabesi është të kërkosh vullnetarisht të dënohesh me një vdekje të pasosur.

*

Në përfundim të këtij zbulimi të shpejtë mbi besimin në BR mund të themi që besimi i krishterë ka dy karaktere thelbësore. Siç e pamë ka një *karakter mendor pranimi të vërtetave* që Krishti ka zbuluar dhe që apostujt e tij kanë predikuar. Prandaj ne nuk mundemi të kemi thjesht një shpresë në Krishtin që na shpëton nga mëkati. Ka pastaj një *karakter dashurues dhe pranimi të personit historik të Jezus Nazarenit*: është prandaj dashuri të paktën fillestare, ndaj Krishtit, është një dhuratë me të cilën ne i falim veten atij. Prandaj besimi është një takim personal i të krishterit me Krishtin që duhet të bëhet gjithnjë e më i thellë, derisa të jetojmë me Krishtin dhe në Krishtin duke u bërë kështu ai jeta jonë. Besimi prandaj është shpresë dhe lëshim në duart e Krishtit Shpëtimtar dhe Shpërblyes, që ai të lirojë nga mëkati atë që beson tek Ai dhe e drejton tek Ati. Është e qartë që besimi nuk vjen nga njeriu por është dhuratë e Hyjit, e që duhet nga ana e njeriut të jetë i vendosur për Krishtin, Krishti duhet të jetë zgjedhja e tij, gjë kjo e vështirë dhe e dhembshur, por që hiri - që Hyu ia jep çdo njeriu, ia bën të mundur atij që nuk i mbyll sytë para dritës, duke preferuar të qëndrojnë në mëkat: “Kushdo që bën të keqen urren dritën dhe nuk vjen te drita; ... por kush vepron të vërtetën vjen tek drita” (Gjn 3,20-21).

Don Ndoc Nogaj